



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.04

Prishtinë, më 27.10.2017, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Jasmina Zhivković dhe Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë: Zv.ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, Helvetas/DEMOS, INPO, BIRN, SPRTK, KDI, Arbresh.Info dhe Kosovapress.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit, me këtë

Rend të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.10.2017;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën;
4. Nisma legjislative e Komisionit për hartimin e Projektligjit për Radio-Televizionin e Kosovës;
5. Nisma legjislative e Komisionit për hartimin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.10.2017

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën

Nait Hasani, njoftoi komisionin që P/ligjin, Qeveria e ka adresuar në Kuvend më 12.10.2017 dhe sipas Rregullores së Kuvendit, komisioni është i obliguar të shqyrtojë dhe të procedojë për Kuvend për miratim në parim.

Për fillim, ai i kaloi fjalën përfaqësuesit të Qeverisë – Ministrisë së Pushtetit Lokal, dhe pyeti zv.ministrin, për hartimin e draftit; a janë marrë disa modele të kryeqyteteve nga shtetet e rajonit, apo është marrë vetëm një model nga një shtet.

Bashkim Krasniqi, zv.ministër, tha se MAPL sipas agjendës për vitin 2017, ka hartuar P/ligjin i cili përmban: organizimin, funksionimin e Prishtinës me status të veçantë, ndërsa kufijtë administrativ të Prishtinës caktohen me ligjin për kufijtë administrativ të komunave.

Karakteristikë kryesore e P/ligjit për Prishtinën është financimi shtesë për komunën, kompetencat shtesë, shërbimet shëndetësore dhe policia komunale. P/ligji është hartuar duke i marrë modelet e disa shteteve për hartimin e tij.

Nait Hasani, pyeti: P/ligji a është draft i Qeverive të kaluara apo është draft i hartuar nga Qeveria aktuale, kah do të merret buxheti për t'ju dhënë kryeqytetit si buxhet shtesë dhe a mund të ketë ndarja e buxhetit implikime buxhetore shtesë, gjithashtu nuk është e qartë çështja e sigurimeve shëndetësore komunale.

Shqipe Pantina, meqë është shqyrtimi i P/ligjit, para miratimit në parim, P/ligji i përmbush kushtet e një drafti për miratim, është normal që Prishtina, kryeqyteti, të ketë status të veçantë mbi bazën e faktit që jeta administrative e diplomatike është e koncentruar në kryeqytet.

Ajo, iu propozoi anëtarëve të komisionit, që së bashku të mendojnë se si e duan një kryeqytet.

Xhevahire Izmaku, tha se përkrah propozimet që P/ligji duhet të miratohet, por ishte skeptike se do të jetë punë e lehtë për arsye se miratimi i P/ligjit do të ndikon në plotësimin dhe ndryshimin e disa ligjeve në fuqi, si Ligjit për shëndetësinë, për vetëqeverisjen lokale, Ligjin për Policinë, etj.

Milaim Zeka, tha se është e habitshme për qeveritë e kaluara, të cilat e kanë tensionuar kryeqytetin duke mos e miratuar Ligjin për Prishtinën, duke ditur që kryeqyteti në të gjitha shtetet është një mini shtet i shtetit.

Ai përkrahu propozimin për miratimin në parim të P/ligjit, duke theksuar se me miratimin e tij do të krijohen kushtet e reja për qytetarët e Prishtinës, shërbimet shëndetësore, rendi publik nga policia komunale.

Rasim Selmanaj, tha se edhe pse i vonuar P/ligji duhet të miratohet pavarësisht përcaktimeve politike.

Imet Rrahmani, duke përkrahur miratimin në parim të P/ligjit, tha se duhet pasur parasysh kolizionin e ligjeve që do të sjellë Ligji për Prishtinën. Gjithashtu, ai tha, se është vështirë që për dy vite, siç është e përcaktuar në draft të ndërtohet spitali i Prishtinës.

Riza Shillova, drejtor i Departamentit të Hetimeve të Kosovës, njoftoi komisionin për vërejtjet qëi ka Policia e Kosovës për nenin 7 të tekstit të P/ligjit, të cilat vërejtje i kishin prezantuar edhe në grupet punuese gjatë hartimit të tekstit të draftit në Qeveri, në të cilat grupe kanë qenë pjesë e punës së përbashkët, por vërejtjet dhe komentet e tyre nuk janë aprovuar.

Në rolin e përfaqësuesit të Policisë së Kosovës, u deklarua që në parim e përkrahin ngritjen e kapacitetit dhe mbikëqyrjes së policisë në kryeqytet, por Ligji për Kryeqytetin duhet të jetë i harmonizuar me Ligjin për Policinë, i cili është hartuar sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Ngritja e kapaciteteve duhet të caktohet në harmoni me strukturën organizative dhe zinxhirin komandues, kjo nënkupton që sa mëi definuar të jetë zinxhiri komandues aq më i ngritur është efikasiteti i punës së policisë, ngase unifikimi i strukturave policore është standard i BE-së, ndërsa sipas P/ligjit për Prishtinën strukturat organizative të Policisë së Kosovës degëzohen.

Konstatim:Komisioni pas diskutimeve të lartcekura unanimisht votoi për miratimin në parim të P/ligjit për Prishtinën dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

4. Nisma legislative e Komisionit për hartimin e Projektligjit për Radiotelevizionin e Kosovës

Nait Hasani, njoftoi komisionin se janë plotësuar kushtet për nismën legislative konform nenit 53, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, nga anëtarët e komisionit për hartimin e tekstit të draftligjit për Radio-Televizionin e Kosovës, gjithashtu njoftoi komisionin, se komisioni i legjislaturës së kaluar, ka hartuar Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për RTK-në, por pas shpërbërjes së Kuvendit çështja ka mbetur në pikën zero.

Për fillimin e nismës legislative propozoi formimin e grupit punues duke kërkuar përkrahjen e anëtarëve të komisionit.

Shqipe Pantina, tha se nisma legjislative nga komisionika një dallim nga shqyrtimi i P/ligjeve të sponsoruara nga Qeveria, në këtë kontekst grupi punues duhet të jetë i gjerë, përveç anëtarëve të komisionit, të marrin pjesë: KPM, Bordi i RTK-së dhe ekspert të fushave mediale.

Xhevahire Izmaku, propozoi që grup punues të jetë vetë komisioni në përbërje të plotë, Bordi i RTK-së, përfshirë menaxhmentin dhe Zyrën ligjore.

Milaim Zeka, propozoi që pjesë e grupit punues të jetë vetëm Sindikata e RTK-së, ekspertë ndërkombëtarë nga Suedia dhe si model për hartimin e draftit të merret ligji i transmetuesit publik të Suedisë.

Rasim Selmanaj, propozoi që si model për hartimin e draftit të merret model ligji i vetëm një vendi, kjo nënkupton të mos kombinohen ligjet e disa vendeve.

Nait Hasani, përkrahu propozimet që grupi punues të jetë komisioni në përbërje të plotë dhe për hartimin e draftit të merret si model ligji i transmetuesit publik i vetëm një vendi.

Konstatim: Komisioni unanimisht përkrahu propozimin e sipërhënuar dhe nxori këtë,

V E N D I M

1. Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Loka dhe Media, do të hartojë Projektligjin për Radiotelevizionin e Kosovës;
2. Komisioni në përbërje të plotë do të hartojë Projektligjin për Radiotelevizionin e Kosovës;
3. Komisioni do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, grupet e interesit të cilët do ta ndihmojnë komisionin me ekspertiza për hartimin e këtij Projektligji;
4. Shpenzimet për punën e grupit të punës për zbatimin e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Komisionit, respektivisht nga buxheti i Kuvendit.

5. Nisma legjislative e Komisionit për hartimin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kryetari i komisionit, për këtë pikë të rendit të ditës, njoftoi anëtarët e komisionit se janë plotësuar kushtet për fillimin e nismës legjislative, konform nenit 53, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, nga anëtarët e komisionit për hartimin e tekstit të draft-ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Për hartimin e draft-ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni vendosi që të punojë në përbërje të plotë.

Konstatim: Komisioni unanimisht përkrahu propozimin e sipërhënuar dhe nxori këtë,

V E N D I M

1. Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokaledhe Media, do të hartojë Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
2. Komisioni në përbërje të plotë do të hartojë Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
3. Komisioni do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, grupet e interesit të cilët do ta ndihmojnë komisionin me ekspertiza për hartimin e këtij Projektligji;
4. Shpenzimet për punën e grupit të punës për zbatimin e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Komisionit, respektivisht nga buxheti i Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të fillohet me hartimin e draftligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën:12:10.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani